

VENDIM
Nr.138, datë 28.3.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT
VENDOR “RADIO ARMONIA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21, neni 25 dhe neni 33, pika 1 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.738, datë 29.9.2008 “Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.

VËREN SE:

KKRT-ja me vendimin nr.345, datë 20.5.2005, ka licencuar shoqërinë “Dropulli” sh.p.k., si operator vendor radio FM private në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastrë. Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar: “Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara përfundimit të saj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendos për rinovimin ose për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave të reja nëse i licencuari nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji”.

Me shkresën nr.170 prot., datë 18.2.2008, KKRT-ja ka njoftuar subjektin radiofonik vendor privat “Radio Armonia” se nëse dëshiron të vazhdojë veprimtarinë për të cilën është licencuar, duhet të paraqesë kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës deri në datën 23.2.2008.

Në mungesë të shfaqjes së interesit, KKRT-ja me vendimin nr.738, datë 29.9.2008, ka vendosur të bëjë paraprakisht të pavlefshme licencën nr.063/FML për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Armonia”, duke i lënë subjektit një afat 30 prej ditësh për të parashtruar pretendimet e tij lidhur me vendimin e mësipërm. Rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë pretendim.

Gjatë periudhës së licencimit të subjektit radiofonik vendor privat “Radio Armonia” nga inspektimet e herëpashershme për kontrollin e spektrit të frekuencave ka rezultuar se operatori në fjalë nuk është gjetur në transmetim.

Licenca e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia” ka përfunduar në datën 30.5.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, neni 25 dhe neni 33 pika 1, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.738, datë 29.9.2008 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.063/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati